



KOALICIONI AAK - NISMA - KONSERVATORËT DHE E-30 PARAQESIN PJESË TË PROGRAMIT QEVERISËS PËR ZGJEDHJET E 9 SHKURTIT

HARADINAJ DHE LIMAJ: KOSOVA KA NEVOJË PËR NORMALITET.

FAQE 4




Lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se zgjedhjet e 9 shkurtit janë mundësi e jashtëzakonshme që Kosova t'i kthehet normalitetit. Ai ka thënë se koalicioni i drejtuar nga ai tashmë e ka draftin e

programit qeverisës dhe strategjinë kundër "fushatës linçuese të Albin Kurtit dhe ushtrisë së tij të internetit". Edhe lideri i Nismës, Fatmir Limaj, ka thënë se Kosova më shumë se kurrë ka nevojë t'i

kthehet normalitetit. Ai ka thënë se tash e katër vjet vendi ka stagnuar në të gjitha fushat. Haradinaj, Limaj dhe partnerët e tjerë të koalicionit kanë premtuar se paga mesatare në Kosovë do të jetë një mijë euro

DËSHMIA KONTROVERSE NË HAGË E ISH-OFCERIT TË KFOR-IT: FUSHATA E BOMBARDIMEVE TË NATO-S NUK ISHTE PËR PAQE

F. 5



OSMANI TAKOHET ME KOMANDANTIN E KFOR-IT, KËRKON HAPJEN E URËS NË KOORDINIM ME ALEATËT

F. 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

GEORGE F. KENAN: MEMOARE
1925 - 1950 (3)

SI DO T'I MBAJË RUSIA TERRITORET DHE POPUJT E PUSHTUAR?

F. 9-11

Shkruan:
Prof. dr. Agim ZOGAJ



AKTUALE



THEMELORJA KONFIRMON AKTAKUZËN NDAJ MINISTRES GËRVALLA PËR MOSDEKLARIM TË PASURISË

F. 7

AKTAKUZË NDAJ ISH-KRYESHEFIT TË KEK-UT, NAGIP KRASNIOI

F. 5

DY TË VDEKUR NGA COVIDI NË KOSOVË, VISHAJ: S'KA VEND PËR PANIK

F. 6

EKONOMI



SHKELJA E TË DHËNAVE PERSONALE, AIP SHOIPTON GJOJË NDAJ KOMPANISË KESCO

F. 8

GËRXHALIU PËR RAPORTIN E 'FDI INTELLIGENCE': ËSHTË I SPONSORIZUAR, USHQEN MILITANTËT POLITIKË, POR JO EKONOMISTËT

F. 8

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shagiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Francë, zjarret djegin mbi 400 hektarë sipërfaqe pyjore

PARIS, 19 GUSHT - Mbi 400 hektarë sipërfaqe pyjore janë djegur nga zjarret në rajonin Hérault të Francës. Sipas lajmit të "BFMTV", një zjarr ka shpërthyer në dy lokacione në provincën Hérault në bregun jugor të vendit, njëri në Massif de la Gardiole dhe tjetri në qytezën Nissan-lez-Enserune. Ndërsa 450 zjarrfikës kanë mbështetur me helikopter përpjekjet për shuarjen e zjarrit

në qytezën Gigean, që ndodhet në Massif de la Gardiole. Bëhet me dije se flakët që mbërritën pranë autostradës A9 u vendosën në kontroll. Për shuarjen e zjarrit është shfrytëzuar edhe uji nga disa pishina private në Frontignan dhe pavarësisht të gjithë ndërhyrjes, është djegur një sipërfaqe prej 340 hektarësh. Në anën tjetër vihet në dukje se gjatë natës ka rënë zjarr edhe

në Nissan-lez-Enserune, 60 kilometra larg Gigean. Përpjekjet e ndërhyrjes për zjarrin në Nissan-lez-Enserune vazhdojnë me 220 zjarrfikës, 2 helikopterë dhe një avion zjarrfikës. Deri më tani është djegur një sipërfaqe mbi 60 hektarë. Prefektura Hérault njoftoi se në zonat e kërcënuara nga zjarri janë kryer proceset e evakuimeve.



Sëmundjet kardiovaskulare janë shkaktarët më të mëdhenj të vdekjeve në Gjermani

BERLIN, 19 GUSHT - Sëmundjet kardiovaskulare janë renditur edhe një herë si shkaktarët kryesorë të vdekjeve në Gjermani. Vitin e kaluar, një e treta, apo 33.9 për qind e të gjitha vdekjeve, janë regjistruar nga sulmet në zemër, apo komplikime të ngjashme, sipas Zyrës Federale të Statistikave. Kanceri ka qenë shkaktar i më shumë se një të pestës së atyre që kanë vdekur, apo 22.4 për qind. Megjithatë, statistikatat tregojnë për një rënie të numrit të vdekjeve, të lidhura me këta dy shkaktarë, në krahasim me vitin paraprak: 2.7 për qind rënie e

numrit të vdekjeve nga sëmundjet kardiovaskulare dhe 0.5 për qind më pak vdekje prej kancerit. Për herë të parë prej vitit 2016 është zvogëluar edhe shifra totale e të vdekurve. Prej 1.07 milion personave të vdekur më 2022, shifra totale ka rënë për 3.6 për qind, apo 1.03 milion më 2023. Më shumë se gjysma e grave që kanë vdekur, dhe pothuajse një e treta e burrave që kanë vdekur, kanë qenë 85 vjeç e më të moshuar. Në krahasim me shifrat më lart, është rritur numri i njerëzve që kanë vdekur prej gripit sezonal dhe pneumonisë.



Republikanët e Dhomës së Përfaqësuesve publikojnë raportin: Bideni ka kryer vepra të papranueshme



WASHINGTON, 19 GUSHT - Republikanët në Dhomën e Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan publikuan këtë të hënë një raport në të cilin pretendojnë se presidenti i ShBA-së, Joe Biden, ka kryer vepra të papranueshme, domethënë se ka shkëmbyer ndikimin për pasurimin personal dhe familjar përmes punëve të jashtme që filluan në vitin 2014. Raporti prej 291 faqesh, i hartuar nga tre komitete të Dhomës së Përfaqësuesve, pretendon se Bideni ka përfituar nga një skemë e shitjes së ndikimit për ta pasuruar veten dhe anëtarët e familjes së tij nëpërmjet

marrëveshjeve me jashtë që filluan në vitin 2014, kur Bideni ishte nënkryetar i ShBA-së, raporton "Reuters". Më tutje është thënë se Bideni e ka përdorur ndikimin e tij për të siguruar që djali i tij, Hunter Biden, të përfitonte nga marrëdhëniet e biznesit me partnerë nga Ukraina, Kina, Rusia dhe vende të tjera. Agjencia ka thënë se është e paqartë nëse kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve, Mike Johnson, do të caktojë një votim për ta fajësuar Bidenin deri pas zgjedhjeve presidenciale të 5 nëntorit. Edhe nëse Dhoma e Përfaqësuesve, e cila kontrollohet

nga republikanët, do të miratonte një vendim të tillë, nuk ka gjasa që Bideni të shkarkohet, duke pasur parasysh se ai do të duhej të fajësohej në Senatin e Kongresit, i cili kontrollohet nga demokratët. Bideni, i cili është tërhequr nga fushata e rizzgjedhjes më 21 korrik, do të largohet nga detyra kur pasardhësi i tij ta bëjë betimin më 20 janar. Demokratët e shohin përpjekjen e republikanëve për ta fajësuar Bidenin si hakmarrje ndaj demokratëve të Dhomës së Përfaqësuesve që e kanë akuzuar Trumpin dy herë, ndërsa Senati ka refuzuar ta bënte këtë.

Avioni luftarak "F-16" bën fluturimin e tij të parë mbi Sllovaki

BRATISLAVË, 19 GUSHT - Një nga avionët luftarakë "F-16" të dorëzuar së fundmi në Sllovaki ka bërë fluturimin e tij të parë mbi Sllovaki, kanë njoftuar Forcat e Armatosura të Sllovakisë. Siç është thënë, këta avionë do të kenë një vlerë të paçmueshme për sigurinë e Sllovakisë,

raporton agjencia sllovake "TASR". Dy avionët e parë luftarakë të prodhimit amerikan "F-16" janë ulur në aeroportin ushtarak në Kuçinë më 22 korrik. "F-16" i tretë pritet të mbërrijë në Sllovaki në tetor dhe pesë avionë të tjerë do të mbërrijnë më 2025. Në fund të vitit 2018

Sllovakia ka lidhur një kontratë për blerjen e gjithsej 14 avionëve luftarakë "F-16". Në prill të vitit të kaluar ky anëtar i NATO-s ka dorëzuar të 13 avionët luftarakë "MiG-29" që i kishte premtuar Ukrainës, njoftoi në atë kohë Ministria e Mbrojtjes e Sllovakisë.



“Vdekje shqiptarëve”, Kamberi dënon mesazhin kërcënues ndaj shqiptarëve në Bujanoc

BUJANOC, 19 GUSHT - Deputeti shqiptar në Parlamentin e Serbisë, Shaip Kamberi, ka reaguar ndaj mesazhit kërcënues ndaj shqiptarëve të Luginës në të cilin është thënë “vdekje shqiptarëve”. Kamberi ka shkruar në “Facebook” se ky gjuha e

urrejtjes në Luginë ka marrë hov. “Mesazhet kërcënuese për shqiptarët në Bujanoc janë shndërruar në përditshmëri. Sot, në hyrjen e repartit për fëmijë, në Shtëpinë e shëndetit në Bujanoc, është vendosur ky mbishkrim: ‘Vdekje

shqiptarëve. Nuk ju duam. Kosova është Serbi’! Ky është mesazhi i dytë brenda një jave i këtij lloji. Gjuha e urrejtjes e kërcënimeve ndaj shqiptarëve në Bujanoc kan marr hov. Ftoj organet e rendit që të zbardhin rastin në tërësi”, ka shkruar Kamberi.




Kurti udhëton për në ShBA, merr pjesë në Konventën e demokratëve

Prishtinë, 19 gusht - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka udhëtuar për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (PDK). Ai do të marrë pjesë në Konventën Kombëtare Demokratike e cila zhvillohet në Çikago. Kryeministri Kurti do të jetë pjesëmarrës edhe në një panel diskutimi me titull: “Konventa Kombëtare Demokratike dhe roli i partive politike”. Paneli do të hapet nga kryesuesi i bordit drejtues të NDI-së, Tom Daschle, dhe do të moderohet nga presidentja e NDI-së, Tamara Wittes. Pjesë e panelit do të jenë edhe ish-sekretari i NATO-s, Lord George Robertson

dhe Donna Brazile, ish-drejtuese e Komitetit Kombëtar Demokrat, tashmë pjesë e bordit të NDI-së. Gjatë qëndrimit në ShBA, kryeministri Kurti do të ketë edhe takime të ndryshme bilaterale. Konventa Kombëtare e Demokratëve mbahet më pak se një muaj pas largimit të prituri të presidentit aktual Joe Biden nga gara presidenciale. Kjo ngjarje, që do të shfaqet nëpër televizione, i ofron mundësinë nënpresidentës Kamala Harris, tashmë e konfirmuar si e nominuar e demokratëve për presidente, që t’i prezantojë qëndrimet e veta para një audience kombëtare.



Osmani takohet me komandantin e KFOR-it, kërkon hapjen e urës në koordinim me aleatët



PRISHTINË, 19 GUSHT - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka prituri të hënën në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Ozkan Ulutash. Në takim është diskutuar për zhvillimet e fundit në fushën e sigurisë, përfshirë çështjen e hapjes së urës së Ibrit. Presidentja Osmani ka përsëritur qëndrimin e saj se çështja e hapjes së urës nuk duhet asesi të bëhet temë e dialogut me Serbinë. Osmani ka ritheksuar se hapja e urës si akt normalizimi e integrimi është në interes të të gjithë qytetarëve pa dallim etnie.

Në këtë drejtim presidentja Osmani ka cekur rëndësinë e konsultimit dhe koordinimit në mes të institucioneve tona dhe partnerëve tanë të sigurisë, veçanërisht me NATO-n, në mënyrë që të ndërtohet plani i përbashkët i zbatimit për hapjen e urës për çdo qarkullim, që ka parasysh vlerësimet e sigurisë dhe interesat e qytetarëve tanë. Presidentja Osmani e ka falënderuar komandantin e KFOR-it për angazhimin personal si dhe të gjithë ushtarëve të KFOR-it për mirëmbajtjen e paqes dhe sigurisë në vend.

“Miq të Amerikës” festojnë ditëlindjen e 78 të Bill Clintonit

Prishtinë, 19 gusht - Shoqata “Miq të Amerikës” ka festuar 78-vjetorin e lindjes së ish-presidentit amerikan Bill Clinton. Në kremtim e pranishme ishte edhe këngëtarja Shkurte Fejza. Kryetari i kësaj shoqate, Agim Rexhepi, ka falënderuar ish-presidentin amerikan Bill Clinton për çlirimin e Kosovës. “Kjo është me tregu që populli i Kosovës është

falënderues për veprimet që i kanë bërë ShBA-ja me aleatët për Kosovën dhe Shqipërinë. Presidenti Clinton ishte ai që dha urdhrin për intervenimin e NATO-s në Kosovë dhe shumë presidentë të tjerë. Po e respektojmë institucionin e Presidencës së Amerikës dhe kështu e respektojmë edhe shtetin tonë”, është shprehur Rexhepi. Ndërsa këngëtarja Shkurte

Fejza e ka quajtur ish-presidentin Clinton mik të madh të shqiptarëve. “Po ndihem e privilegjuar për këtë moment që ma dhurojat. Emri i tij është gdhendur në çdo zemër të shqiptarëve. Ne e kujtojmë këtë mik të madh të shqiptarëve që iu gjet Kosovës në kohët më të vështira. Është ndër personalitetet më të zgjuara që ka bota”, ka thënë Fejza.





KOALICIONI AAK - NISMA - KONSERVATORËT DHE E-30 PARAQESIN PJESË TË PROGRAMIT QEVERISËS PËR ZGJEDHJET E 9 SHKURTIT

Haradinaj dhe Limaj: Kosova ka nevojë për normalitet

Lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se zgjedhjet e 9 shkurtit janë mundësi e jashtëzakonshme që Kosova t'i kthehet normalitetit. Ai ka thënë se koalicioni i drejtuar nga ai tashmë e ka draftin e programit qeverisës dhe strategjinë kundër “fushatës linçuese të Albin Kurtit dhe ushtrisë së tij të internetit”. Edhe lideri i Nismës, Fatmir Limaj, ka thënë se Kosova më shumë se kurrë ka nevojë t'i kthehet normalitetit. Ai ka thënë se tash e katër vjet vendi ka stagnuar në të gjitha fushat. Haradinaj, Limaj dhe partnerët e tjerë të koalicionit kanë premtuar se paga mesatare në Kosovë do të jetë një mijë euro

siguri Kurti e ka mision që në fund të mandatit t'i rrisë pagat. Ne e kemi nisur punën për zgjedhjet e 9 shkurtit. Përgatitjet kanë nisur. Tani kemi draftin e parë të planit tonë qeverisës. Kemi strategji edhe si të përballemi me fushatat linçuese të Kurtit dhe ushtrinë e tij të internetit”, ka thënë Haradinaj.

rikapitullim i të gjithë atyre premtimeve që kanë ardhur në pushtet. Të bëhet një llogaridhënie e të gjitha veprimeve të tyre. Me katër vjet qeverisje, cilët janë sektorët që janë zhvilluar? Kosova më shumë se kurrë ka nevojë t'i kthehet normalitetit. Tash e katër vjet kemi pasur trauma, frikë si shoqëri. Tash e katër vjet vendi ka stagnuar në të gjitha fushat. Për katër vjet Kosova nuk mori asnjë njohje. Kanë prishur imazhin tonë të ndërtuar me vështirësi në arenën ndërkombëtare. Kosova është kthyer në delen e zezë në rajon pa asnjë arsye. S'kanë marrë asnjë investim serioz direkt. Kosova i ka pasur mundësitë e veta, por nuk janë shfrytëzuar. Ky vend është i pasigurt dhe kjo qeveri nuk ka krijuar kushte. Ka pasiguri juridike. Kemi eksperimentuar mjaft me fatin e shtetit tonë. Që katër vjet është eksperimentuar. Është koha ta ndalim këtë. Është koha për llogaridhënie dhe për mundësi të re”, ka thënë Limaj, duke shtuar se në vend që Kosova të ishte drejt anëtarësimit në NATO dhe BE, ajo ballafaqohet me sanksione. “Këta kanë qenë njerëz të suksesshëm në mbylljen e dyerve të vendit tonë”, ka thënë Limaj.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 19 GUSHT - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka premtuar se në qeverisjen e koalicionit AAK - Nisma - Konservatorët dhe E-30 paga mesatare në Kosovë do të jetë një mijë euro, ndërsa nuk do të ketë asnjë pagë më të vogël se 500 euro. Në një konferencë të përbashkët të këtij koalicioni, Haradinaj ka thënë se zgjedhjet e shpallura më 9 shkurt 2025 janë “një mundësi e jashtëzakonshme që të kthehemi në normalitet”. Ai ka shtuar se ky koalicion tashmë e ka draftin e programit qeverisës, madje edhe një strategji për “fushatat linçuese të Albin Kurtit dhe ushtrisë së tij të internetit”. Më tutje, Haradinaj ka theksuar

se populli i Kosovës nuk është analfabet, ashtu siç, sipas tij, e ka cilësuar qeveria Kurti e se “është popull mirënjohës ndaj Amerikës dhe se nuk lejon asnjë qeveri t'i lëndojë raportet tona me aleatët dhe rrugën tonë euroatlantike”. “Zgjedhjet e shpallura më 9 shkurt 2025 janë një mundësi e jashtëzakonshme që të kthehemi në normalitet. Sidoqoftë, më 9 shkurt 2025 populli i Kosovës do të dijë të dëshmojë se nuk është popull analfabet, ashtu siç e ka cilësuar kjo qeveri. Populli nuk mashtrohet, nuk harron e nuk gabon. Është popull mirënjohës ndaj Amerikës dhe se nuk lejon asnjë qeveri t'i lëndojë raportet tona me aleatët dhe rrugën tonë euroatlantike, nuk e lejon askënd ta kthejë prapa e ta stagnojë zhvillimin e vendit, se nuk e lejon askënd të krijojë


kriza artificiale, me qëllimin e vetëm mbetjen në pushtet pavarësisht çmimit”, ka thënë Haradinaj, duke shtuar se me partnerët e koalicionit janë bërë bashkë për ta ndaluar të keqen në Kosovë. “Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me partnerët e saj në koalicion, Nisma, Konservatorët, Intelektualët, janë bërë bashkë të përballen me ata që kanë shkelur mbi çdo vlerë, kanë fyer, kanë nënçmuar e kanë shpifur, kanë tradhtuar besimin e qytetarit, kanë tradhtuar të varfrit, e kanë tradhtuar edhe diasporën”, ka thënë Haradinaj. Ai ka theksuar se ky mandat do të jetë i fundit për kryeministrin Albin Kurti. “Për ta kthyer besimin e qytetarëve, që në ditët e para të qeverisjes sonë nuk do të ketë pagë mesatare nën një mijë euro dhe nuk do të ketë asnjë pagë nën 500 euro. Me

Limaj: Koha për normalitet, që 4 vjet vendi mori trauma, stagnim dhe asnjë njohje

Ndërsa kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se zgjedhjet e reja do të jenë një mundësi e rikapitulimit të premtimeve të qeverisë Kurti dhe llogaridhënie e veprimeve të saj. Sipas Limajt, Kosova më shumë se kurrë ka nevojë t'i kthehet normalitetit. Ai ka thënë se tash e katër vjet vendi ka stagnuar në të gjitha fushat, duke shtuar se në drejtimin e Albin Kurtit Kosova nuk ka marrë asnjë njohje. “Shpallja e datës zgjedhore është datë e rëndësishme. Ne bashkë si shoqëri angazhimin e kemi për ta ruajtur demokracinë. Është një moment i mirë, të bëhet një rikapitullim i të gjithë veprimeve të tyre. Të bëhet një

Dëshmia kontroverse në Hagë e ish-oficerit të KFOR-it: Fushata e bombardimeve të NATO-s nuk ishte për paqe

HAGË, 19 GUSHT - Ish-oficeri i forcave amerikane në KFOR, Steve Russell, ka dëshmuar të hënën në procesin gjyqësor kundër krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Russell ka shërbyer kryesisht në zonën e Gjilanit dhe ka folur për disa pretendime për qendra ndalimi atje në vitin 1999. Por, mbrojtja ka sfiduar qëndrimet e tij për UÇK-në dhe NATO-n, pasi në dëshminë e tij me shkrim para Prokurorisë kishte dhënë deklarata të çuditshme për ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë. Mbrojtja e Hashim Thaçit e ka pyetur për qëndrimet e tij se ai e ka parë ndërhyrjen e NATO-s jo me qëllime paqësore dhe për më tepër rolin e Amerikës në luftën e Kosovës dhe ndërhyrjen ushtarake e shihte si marrje të anës. “Ne po shkonim aty për ta zbatuar Rezolutën 1244 që ishte rezultat i ndërhyrjes në sovranitetin e Serbisë në emër të vuajtjes së shkaktuar në provincën e Kosovës dhe mendova që në këtë kontekst ne po ndërhynim në sovranitetin e Serbisë për ta zbutur vuajtjen e njerëzve në provincën e Kosovës, kështu do ta shpjegoja unë”, ka thënë Russel kur është pyetur për qëndrimin e tij se pozicioni i Amerikës në atë kohë ishte i anshëm.



Ai është pyetur, po ashtu, për deklaratën e dhënë para prokurorisë, ku kishte thënë se fushata ajrore e NATO-s nuk kishte qëllim paqeruajtës, por më shumë të impononte një rezultat. “Nuk e di nëse është në procesverbal, por mendoj që është e vështirë për forcat ajrore të arrijnë në një përfundim apo të sjellin rezultat pa praninë në terren dhe mendoj që ka shumë histori për t’u mbështetur në këtë që po them”,

është përgjigjur ai. Mbrojtja ka thënë se pyetja kishte të bënte më shumë me rezultatin e jo më efikasitetin, por Russel ka thënë se e kuptonte këtë më shumë nga aspekti ushtarak për të zgjidhur një çështje. Pasi e ka sfiduar me këto qëndrime kontroverse, mbrojtja ia ka lëshuar dëshmitarit fjalimin e ish-presidentit amerikan Bill Clinton kur kishin nisur bombardimet e NATO-s mbi Serbinë dhe qëllimin

e tyre për ta mbrojtur popullatën civile. “A është kjo që tha presidenti Clinton në përputhje me njohuritë që kishit ju për arsyet që NATO ndërhyri?”, e ka pyetur avokatja dëshmitarin. Në këtë rast, ai sikur ndryshoi qëndrimet e dikurshme, duke shtuar për fjalimin e Clinton: “Besoj që kjo ka qenë ajo që e mendonim të gjithë ne”. Avokatja nxjerr raportin e DASH-it: Thaçi dënoi sulmin ndaj serbëve

në Grackë, s’ka asnjë provë që udhëheqja e UÇK-së të ketë dirigjuar dhunën. Gjatë seancës avokatja e Thaçit ka publikuar një raport të Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH), ku ka theksuar qartë që Hashim Thaçi ka dënuar sulmet ndaj civilëve serbë si dhe ka dënuar sulmin ndaj serbëve në Grackë të Lipjanit. Sipas Departamentit Amerikan të Shtetit, udhëheqja e UÇK-së nuk e kishte dirigjuar dhunën në Grackë. “Një deklaratë e 20 korrikut dënonte sulmet ndaj serbëve dhe romëve dhe kjo deklaratë doli nga udhëheqja e ish-UÇK-së, konkretisht nga ish-udhëheqësi Hashim Thaçi. Publikisht denoncoi sulmin e 23 korrikut në Grackë. Nuk ka asnjë provë që udhëheqja e UÇK-së të ketë dirigjuar këtë dhunë”, ka deklaruar avokatja e Thaçit, duke e pyetur dëshmitarin se a ka ndonjë arsye për të vënë ndonjë dyshim në raportin që përgatiti Departamenti Amerikan i Shtetit. Dëshmitari në vijim është përgjigjur në pyetjen e avokates, duke deklaruar se raporti vërtet është përgatitur nga Departamenti i Shtetit dhe se nuk ka asnjë arsye për ta vënë në dyshim.

Arroganca e institucioneve ka për qëllim pengimin e hetimeve

Reagim i KMDLNj-së

Në fshatin Bibaj të Ferizajt, ndodhi një vrasje e një 89-vjeçari e që doli të jetë i afërt me pushtetin aktual që, jodomsdoshmërisht e implikon në këtë vrasje. Në ndërkohë, në gazetën "Nacionale" doli një pjesë e komunikimit në grup në të cilin thuhet se ishin edhe presidentja aktuale, me bashkëshortin, e që në një mënyrë, tërthorazi implikohen në këtë vrasje për faktin se dyshohen se kanë qenë në dijeni për një dhunim të dy të miturave 10 vjeçe, motra të njërit nga dorasit e që këtë dhunim e paska kryer viktimja, axha i bashkëshortit të presidentes gjatë viteve 98, 99. Të gjitha këto thuhet pa përfunduar hetimet nga

institucionet përkatëse dhe pa asnjë vendim të gjykatës. Presidentja e Kosovës, në emër të rrezikimit të jetës së saj dhe familjes, kërkon mbrojtje nga institucionet e sigurisë për çka ka të drejtë ndërsa siguria mund t’i ofrohej pas vlerësimit të rrezikshmërisë nga organet e sigurisë. Përtej kësaj, presidentja e veshur me arrogancën e pushtetit, kërkon të bëhen hetime të menjëhershme ndaj mediave duke i njëjtësuar me mediat e Serbisë në përgjithësi duke individualizuar emrin e Berat Buzhalës nga gazeta “Nacionale”. Me këtë denoncim të pashembullt urdhëron organet hetuese të bëjnë hetime që paraqet ndërhyrje flagrante në punën e këtyre institucioneve, në njërën anë, kërcënon gazetarët dhe gazetat që janë jashtë “vijës



institucionale” ndërkaq, kërcënim i veçantë shkon drejt Berat Buzhalës. Nga pozita dhe fuqia që e ka presidentja, jeta e Berat Buzhalës dhe familjes së tij rrezikohet

shumë më tepër. KMDLNj-së, këto ftesa të përditshme të përfaqësuesve më të lartë institucionalë për hetimin e gazetarëve apo të tjerëve sepse po “ua shkelin thembrën”, në fakt

janë ndërhyrje flagrante për të penguar hetime, siç është vrasja në Bobaj, në mbrojtje të familjarëve dhe moszbulim i rasteve tjera. Në Kosovë pushtetet, sipas ligjeve në fuqi, janë të ndara dhe bartësit e posteve më të larta shtetërore janë pikërisht ata që, të pajisur me pushtet të pakontrolluar e që nuk japin fare llogaridhënie, në mënyrë brutale ndërhyjnë në punën e institucioneve prandaj i konsiderojnë armiq gazetarët duke i përndjekur ata. Rasti në fshatin Bibaj duket të jetë i ngatërruar, i rëndë prandaj duhen hetime të pavarura, mosndërhyrje nga askush, bashkëpunim me policinë dhe prokurorinë e shtetit të gjithë atyre që mund të kontribuojnë në ndriçimin e rastit. KMDLNj-ja thërret që rasti të mos paragjykohe.

Aktakuzë ndaj ish-kryeshefit të KEK-ut, Nagip Krasniqi

Prishtinë, 19 gusht - Prokuroria Speciale e Kosovës ka njoftuar se ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë ndaj të pandehurit Nagip Krasniqi për keqpërdorim të detyrës zyrtare sa ishte kryeshef në KEK. Në njoftimin e prokurorisë është thënë se i pandehuri

për rreth dy vjet ka bërë keqpërdorim. “Sipas aktakuzës, i pandehuri N. K., duke filluar nga data 15 tetor 2021 e në vazhdimësi deri me datë 19 prill 2023, në cilësinë e personit zyrtar, duke e shfrytëzuar detyrën zyrtare, kishte kryer veprat penale ‘Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar’, është

thënë në njoftimin e prokurorisë. Krasniqi ishte arrestuar më 19 prill 2023 pas bastisjeve të Njësisë së Hetimeve Speciale, në zyrën e tij në KEK dhe në dy banesat e tij. Ai dyshohet se ka kryer veprat penale ‘Keqpërdorim i detyrës zyrtare’, ‘Ushtrim ndikimi’ dhe ‘Konflikt interesi’.



Policia në Prishtinë brenda një jave realizoi 136 urdhëresa të gjykatës

PRISHTINË, 19 GUSHT - Nga zyrtarët policorë të rajonit Prishtinës gjatë javës së kaluar në lokacione të ndryshme dhe aksione të ndara janë realizuar 136 urdhëresa të gjykatës, prej tyre 38 urdhëresa për vepra penale, ndërsa të tjerat për kundërvajtje, seanca, verifikime etj. Në njoftimin e Policisë së Kosovës është thënë se

konform urdhëresave, pas përfundimit të procedurave policore, personat e dënuar me burgim janë dërguar për vuajtje të dënimit, ndërsa personat e dënuar me gjobë janë liruar, pasi kanë kryer obligimet e caktuara në urdhëresa. “Ndërkohë që aktivitete policore janë shtrirë edhe në segmente të tjera të sigurisë. Gjatë periudhës së njëjtë janë

sekuestruar 18 armë zjarri, të llojeve dhe kalibrave të ndryshëm. Ndërkaq aktivitetet policore në sferën e sigurisë në trafikun rrugor. Në po të njëjtën periudhë kohore kanë rezultuar me shqiptimin e 4 664 masave administrative me gjobë për lloje të ndryshme të kundërvajtjeve dhe shkeljeve të kodit rrugor”, ka njoftuar policia.



Gashani: Raportimet e qytetarëve për të shtënat me armë në ahengje janë rritur

PRISHTINË, 19 GUSHT - Zëvendësministri i Punëve të Brendshme (MPB), Blerim Gashani, ka bërë me dije se janë rritur raportimet e qytetarëve për të shtënat me armë në ahengje. Këtë deklaratë Gashani e ka bërë gjatë takimit të grupit për implementimin e Strategjisë dhe udhërrëfyesit rajonal për armë të vogla, të lehta dhe eksplozivë, të mbajtur të hënën në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Sipas njoftimit, theks i veçantë në këtë takim i është dhënë fushatës vetëdijesuese: “Festo me zemër, jo me armë”, që është duke u zbatuar aktualisht nga MPB-ja, e për të cilën zëvendësministri është shprehur se do të vazhdojë gjatë gjithë vitit, me qëllim që të arrihen synimet për rënien e numrit të rasteve ku ka të shtëna festive. “Ky takim pati theks të veçantë fushatën vetëdijesuese: ‘Festo me zemër, jo me armë’, që është duke u zbatuar aktualisht nga MPB-ja



dhe me këtë rast zëvendësministri Gashani vuri në pah se kjo fushatë do të vijojë të jetë dinamike gjatë gjithë vitit, me qëllim që të arrihen synimet për rënien e numrit të rasteve ku ka të shtëna festive.

Zëvendësministri Gashani vuri në dukje se fushata është duke i dhënë efektet e saj, pasi kemi një numër të shtuar të rasteve kur qytetarët janë duke i raportuar këto të shtëna, ndërkohë që këto raportime janë duke u trajtuar

seriozisht në veprime konkrete nga Policia e Kosovës, të cilët janë duke ndërhyrë në konfiskimin e armëve dhe arrestimin e të dyshuarave”, thuhet në njoftim. Po në këtë takim është bërë edhe një vlerësim i përgjithshëm i të

gjitha objektivave strategjike dhe zbatimit në praktikë të aktiviteteve që dalin nga Strategjia dhe udhërrëfyesi rajonal, si dhe është diskutuar edhe për sfidat e disa aktiviteteve të tjera.

Dy të vdekur nga Covidi në Kosovë, Vishaj: S’ka vend për panik



Prishtinë, 19 gusht - Drejtori i Klinikës Infektive, Arben Vishaj, ka thënë se dy pacientët që kanë vdekur nga Covid-19 kishin edhe sëmundje të tjera kronike. Përmes një videomesazhi, Vishaj ka thënë se njëri pacient ishte 80-vjeçar, ndërsa tjetri 67-vjeçar. Ai ka thënë se aktualisht në këtë klinikë janë duke u trajtuar 10 pacientë, dy nga ta janë me oksigjeno-terapi. “Aktualisht në Klinikën Infektive i kemi të

shtrirë gjithsej 10 pacientë, dy nga ta janë me oksigjeno-terapi. Dy ditë më parë në Klinikën Infektive dy pacientë kanë përfunduar me vdekje. Njëri në moshën 80-vjeçare i cili ka qëndruar në këtë klinikë dy orë ngaqë ka pasur sëmundje të tjera të rënda kronike. E pacienti tjetër në moshën 67-vjeçare i cili rëngonte nga sëmundje të rënda kronike që ishte duke u trajtuar më përpara në Klinikën Infektive”,

ka thënë Vishaj, duke shtuar se nuk ka vend për panik. “Për momentin në Klinikën Infektive kemi mjaftueshëm oksigjeno-terapi, kemi barna dhe staf mbështetës mjaftueshëm. Mendoj që nuk ka nevojë për ndonjë panik. Ne jemi duke e përcjellë me vëmendje të shtuar situatën epidemiologjike dhe varësisht nga situata do të veprojmë konform situatës e cila vjen”, ka thënë Vishaj.

“Trepça” largon nga puna pesë punëtorë

PRISHTINË, 19 GUSHT - Në muajin gusht punëtorët e ndërmarrjes “Trepça” patën paralajmëruar protesta për mosekzekutimin e pagave për tre muaj, protestë të cilën e kishin anuluar pas mbajtjes së mbledhjes së

qeverisë, ku janë ndarë 4 milionë euro për pagat e minatorëve. Gjatë mbledhjes kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se “ka tepër shumë punëtorë mbi tokë për xehet e pakta të nxjerra nga

toka”. Mesa duket ndërmarrja “Trepça” e ka marrë me seriozitet këtë deklaratë të Kurtit. Vetëm gjatë së hënës ka pezulluar nga puna 5 punëtorë të ndërmarrjes me arsye: “shkelje të detyrave të punës”.



Dibrani: Përkrahja e ShBA-së, jetike për Shërbimin Korrektues të Kosovës

PRISHTINË, 19 GUSHT - Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK), Ismail Dibrani, është duke marrë pjesë në konferencën e Shoqatës Korrektuese Amerikane e cila është duke u zhvilluar në ShBA. Dibrani ka bërë me dije se në këtë konferencë ka takuar drejtuesit e sistemeve korrektuese të shumë vendeve dhe se ka marrë përkrahje nga institucionet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Shërbimin Korrektues të Kosovës. “Jam jashtëzakonisht i

nderuar që në konferencën ndërkombëtare të Shoqatës Korrektuese Amerikane kam takuar drejtuesit e sistemeve korrektuese të shumë shteteve nga ShBA-ja dhe vende të ndryshme të botës. Gjatë takimeve të zhvilluara në ShBA u rikonfirmua bashkëpunimi i përhershëm dhe vazhdimi i përkrahjes nga institucionet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Shërbimin Korrektues”, ka shkruar Dibrani në “Facebook”. Më tutje, ai ka treguar se në Nashville është hapur edhe

panairi ku janë duke u ekspozuar pajisjet e sofistikuar të sigurisë. Me këtë rast, Dibrani ka thënë se përkrahja amerikane është jetike për Kosovën. “Së bashku me zyrtarët e lartë të ICITAP-it kemi identifikuar pajisje të nevojshme që do të sigurohen për ShKK, si: skanerë, kamera detektuese të telefonave, si dhe shumë pajisje të tjera të sigurisë, të cilat pritet të vijnë në Kosovë gjatë muajit tetor. Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbeten partneri kryesor në zhvillim dhe



reformë; përkrahja e tyre është Shërbimin Korrektues të jetike dhe vendimtare për Kosovës”, ka shkruar Dibrani.

Themeloria konfirmon aktakuzën ndaj ministres Gërvalla për mosdeklarim të pasurisë

PRISHTINË, 19 GUSHT - Gjykata Themelore në Prishtinë ka konfirmuar aktakuzën për mosraportim të pasurisë ndaj ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla. Ajo ngarkohet se në cilësinë e zyrtares së lartë publike në formularin për deklarim të pasurisë më 22 mars 2021 nuk ka paraqitur saktë të dhënat e kërkuara me ligj. “Betimi për Drejtësi” ka siguruar vendimin e marrë më 19 qershor 2024, përmes të cilit gjykata i ka refuzuar të pabazuara kërkesat për kundërshtim të provave dhe hedhje të aktakuzës të parashtruara nga mbrojtësja e Gërvallës, avokatja Saranda Keqekolla-Sadiku. E me qëllim që gjykata të ketë një pasqyrë më të qartë lidhur me këtë çështje penale si dhe për faktin se e njëjta detyrohet që saktësisht dhe tërësisht t’i vërtetojë faktet për të marrë një vendim të ligjshëm, ka vendosur që procedura penale e filluar ndaj Gërvallës të vazhdohet tutje në fazat e tjera të procedurës. Lidhur me akuzën për mosraportim të saktë të pasurisë, në seancën fillestare më 7 mars 2024, Gërvalla ishte deklaruar e pafajshme. Më pas avokatja e saj, Keqekolla-Sadiku, kishte parashtruar kërkesë që të hedhet poshtë aktakuza. Mbrojtja kishte pretenduar se nuk ka prova të mjaftueshme për ta mbështetur dyshimin e bazuar mirë se e mbrojtura e saj ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, duke theksuar se aktakuza është e mangët dhe nuk është në harmoni me

kërkesat ligjore. “... ngase Prokuroria nuk ka paraqitur asnjë provë të vetme që kishte për të vërtetuar ‘dyshimin e bazuar mirë’, se e pandehura ishte subjekt i cilësdo formë të kryerjes së veprës penale që i vihet në barrë”, kishte theksuar avokatja Keqekolla-Sadiku në kërkesën e saj. Mirëpo kërkesa e tillë e mbrojtjes, sipas Gjykatës Themelore në Prishtinë, është e pabazuar dhe e njëjta është refuzuar. Gjykata ka gjetur se aktakuza mbështetet në prova të marra konform dispozitave ligjore dhe, sipas saj, nuk ka vend për hedhje të aktakuzës ngase nuk ekzistojnë rrethanat që e përjashtojnë përgjegjësinë penale, vepra penale nuk është përfshirë në parashkrim dhe nuk ka rrethanat të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen penale. “... duke marrë parasysh se në këtë fazë të procedurës penale kemi të bëjmë edhe me ligjshmërinë e aktakuzës, gjykata çmoi se vepra penale për të cilën akuzohet e pandehura përbën vepër penale, andaj duke marrë parasysh se në bazë të nenit 7 të KPRK-së gjykata detyrohet që saktësisht dhe tërësisht t’i vërtetojë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, konsiderojmë se në këtë çështje penale duhet të mbahet shqyrtimi gjyqësor në mënyrë që gjykata të ketë një pasqyrë më të qartë lidhur me këtë çështje penale”, thuhet tutje në vendimin e gjykatës. Po ashtu, pretendimet e mbrojtjes se nuk është vërtetuar implikimi i të



pandehurës në çështjen penale që i vihet në barrë, kjo gjykatë i ka vlerësuar si të pabazuara sepse ngjarja e paraqitur nga mbrojtja nuk mund të shqyrtohet në këtë fazë të procedurës penale. “Për faktin se gjykata nuk është e autorizuar ta bëjë vlerësimin e provave në këtë fazë të procedurës, pretendimet në rastin konkret janë çështje që do të vlerësohen dhe vërtetohen në shqyrtimin gjyqësor të mëtejshëm pas administrimit të provave, ku edhe do të vërtetohet fajësia apo pafajësia e të pandehurës”, është thënë në këtë vendim. Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të përpiluar më 31 janar 2023 nga prokurori Astrit Gashi, Gërvalla ngarkohet se në cilësinë e zyrtares së lartë publike me obligim ligjor të deklarimit të pasurisë, në formularin për deklarim të pasurisë më 22 mars 2021, nuk ka paraqitur saktë të dhënat e kërkuara me ligj.

Aktakuza ka theksuar se e njëjta në këtë formular nuk ka deklaruar asnjë të hyrë të ardhur të bashkëshortit të saj Stefan Schwarz edhe përkundër se të njëjtin e ka deklaruar si bashkëshort. Më tutje, në aktakuzë është thënë se Gërvalla nuk ka deklaruar në tërësi parcelën kadastrale-toka bujqësore në pronësi të saj në sipërfaqe prej 3964 m2 në ZK Dubovik - Komuna e Deçanit, duke e deklaruar vetëm sipërfaqen prej 2000 m2. Po ashtu, Gërvalla, sipas akuzës, thuhet se nuk ka deklaruar as biznesin “Alb Lingua UG”, regjistruar në Bon të Gjermanisë në emër të saj. Me këto veprime Gërvalla akuzohet se ka kryer veprën penale “Mosraportimi ose raportimi i remë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”, nga neni 430, paragrafi 2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Prokuroria Themelore në Prishtinë

më 29 maj 2023 kishte konfirmuar për “Betimi për Drejtësi” se ka ngritur aktakuzë ndaj Gërvallës. “Referuar kërkesës së parashtruar nga ana juaj, ju njoftojmë se Prokurori i Shtetit, më 31.01.2023, ka ngritur aktakuzë ndaj D.G., për shkak të veprës penale “Mos raportimi ose raportimi i remë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, si dhe të njëjtën e ka proceduar në Gjykatë për trajtim të mëtejshëm”, kishte konfirmuar zëdhënësja e kësaj prokurorie, Laureta Ulaj. Pasi ishte bërë me dije lajmi për ngritjen e aktakuzës, ministria Gërvalla përmes një postimi në “Facebook” kishte thënë se është përpjekje për të hedhur baltë mbi përfaqësuesit e institucioneve. Ndryshe, më 2 tetor 2021, “Betimi për Drejtësi” ka raportuar se Donika Gërvalla, zëvendëskryeministre dhe ministre e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës (MPJD), nuk ka deklaruar të gjitha funksionet në institucione vendore dhe ndërkombëtare. Katër muaj pas këtij hulumtimi, Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK), tani Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK), kishte njoftuar se është ende duke trajtuar rastin e ministres Gërvalla. Sipas këtij hulumtimi, rezultoi se Gërvalla nuk ka deklaruar se ka biznes në Gjermani, nuk ka treguar se është drejtoreshë e një fondacioni në Kosovë dhe as nuk ka deklaruar pasurinë e burrit dhe fëmijëve.

Sami Kurteshi ftohet për intervistim nga Prokuroria Speciale

PRISHTINË, 19 GUSHT - Sami Kurteshi nga Lëvizja Vetëvendosje ka bërë me dije se Prokuroria Speciale e ka ftuar për intervistim që, sipas tij, ka të bëjë me deklaratat që ai kishte bërë në lidhje me rastin e Astrit Deharit. “Më 16 gusht 2024, me autorizimin e prokurorit special Bekim Kodraliu, kam pranuar thirrje nga Drejtoria për Hetimin e Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda për marrje në pyetje me datë 20 gusht 2024, në lidhje me deklaratat e bëra në konferencën për media me

rastin e pensionimit të Afrim Shefkiut, i ngarkuar me rastin e Astrit Deharit, të mbajtur para Prokurorisë Speciale”, ka shkruar Kurteshi në “Facebook”. Sipas Kurteshit, ftesa e prokurorisë në thelb nxjerr dy pyetje lidhur me rastin e Astrit Deharit. “Pas marrjes në pyetje të Ministres së Drejtësisë Albulena Haxhiu nga Prokuroria Speciale si dëshmitare për rastin, pas deklarimit publik në rrjetet sociale, në lidhje me rastin A. Dehari, po për deklarimin publik në konferencë për media

për rastin Dehari, më thirr për marrje në pyetje edhe mua. Kjo sjellje e prokurorisë në thelb nxjerr dy pyetje thelbore: A po rifillon hetimi i njëmendtë i rastit A. Dehari nga Prokuroria Speciale? Apo po bëhet përpjekje e njëmendtë për humbje të gjurmëve të vrasjes së Astritit?”, ka shkruar ai. Kurteshi në reagimin e tij ka shtuar se drejtësia për Astrit Deharin do të arrijë, duke shtuar se “Koha vonon, por e drejta nuk shuhet! E drejta domosdo del në shesh”.



Gërxhaliu për raportin e ‘FDI Intelligence’: Është i sponsorizuar, ushqen militantët politikë, por jo ekonomistët

PRISHTINË, 19 GUSHT - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, e ka quajtur të sponsorizuar raportin e “FDI Intelligence” nga “Financial Times”, i cili tregon se “Kosova renditet e dyta në Evropë për zhvillim dhe e pesta në të gjithë botën”.

Sa i përket deklaratimit të kryeministrit Albin Kurti, se ky raport është një dëshmi më shumë se progresi demokratik dhe ekonomik në Kosovë ecin paralelisht, Gërxhaliu ka thënë se ky raport ushqen militantët politikë, por jo ekspertët e ekonomisë. Ai ka thënë se e ka habitur fakti se si një gazetë prestigjioze si “Financial Times” ka një qasje të tillë, kur vetë Kosova është në sanksione ekonomike dhe ka mungesë të madhe të investimeve të huaja.

“Po të mos isha në Kosovë dhe të mos e njihja realitetin kosovar, një lajm i tillë kishte me qenë një lajm bombastik të cilin shumëkush do ta besonte. Në këtë drejtim e ka atë efektin e vet pozitiv në aspektin e perceptimit tek të tjerët, mirëpo realiteti në Kosovë nuk është diçka e tillë. Në rend të dytë më ka

habitur fakti i qasjes së një gazete të tillë prestigjioze, ‘Financial Times’, që do të thotë një shtet i cili është nën sanksione ekonomike të cilat jo vetëm që s’është në plan të hiqen, por tentohet të rendohen dhe të vështirësohen. Flet për një shtet që, përveç diasporës dhe investimeve në patundshmëri, ka zero investime të huaja, në prodhim në teknologji moderne, në rritje të eksporteve dhe në transfer të teknologjisë dhe të edukimit”, ka thënë Gërxhaliu për “EO”.

Ish-kryetari i OEK-t, ka thënë se po të ishte Kosova një mrekulli e tillë ekonomike, vendi nuk do të përballej me largim të të rinjve që, sipas tij, kanë humbur shpresat për të jetësuar këtu. Ai ka thënë se nga përvoja që ka, raporte të tilla shpesh janë të sponsorizuar dhe se gjendjen se si është në vend, sipas tij, e dinë më mirë kosovarët të cilët përballen çdo ditë me realitetin.

“Vetë fakti që nga ky shtet që qenka një mrekulli ekonomike po largohen të rinjtë dhe është humbur shpresa për të jetuar dhe krahas ikjes dhe largimit të qytetarëve po ikën kapitali me të



madhe, duke investuar në vendet e rajonit. Mungesa e stabilitetit politik e ka ngulfatur Kosovën, agenda politike e ka anashkaluar rëndësinë ekonomike dhe sociale dhe shumë më tepër është ta shohim realitetin aty ku jetojmë sesa të mendojmë se çka thonë të tjerët që ndoshta janë të sponsorizuar. Nuk duhet vetëkënaqësi. Definitivisht raporte të shumta nga përvoja ime në të kaluarën kanë qasje sponsorizuese, por në përgjithësi në aspektin ekstrem për ata që nuk e njohin Kosovën, ky mund të jetë

një lajm, dhe mund të jetë një hap drejt ndryshimit, apo krijimit të një perceptimi të ri mbi Kosovën, por e vërteta është e kundërt me atë çka rekomandohet edhe nga ‘Financial Times’ edhe nga institucionet e tjera”, ka thënë ai. Më tutje, Gërxhaliu ka thënë se ky raport mund të ushqejë militantët politikë, por jo edhe ekspertët e ekonomisë. “Pasi lexova raportin, i pashë indikatorët të cilët i ëndërroj që Kosova të jetë aty, por Kosova dhe ky raport janë diametralisht të kundërta. E dëshirojmë një Kosovë të tillë që të jetë në këtë ranglistë

dhe këtë nivel të investimeve, por për diçka të tillë që të arrihet duhet punë, duhet dialog, duhet partneritet, duhet koordinim të aktiviteteve me miqtë ndërkombëtarë dhe me ShBA-në. Sepse në kundërshtim total me BE-në, një luftë diplomatike me ShBA-në dhe të mendosh se ke ambient dhe je shteti më atraktiv për me investime të huaja, kjo është një utopi që mund t’i ushqejë militantët politikë, por jo ekspertët e fushave ekonomike”, ka thënë ai.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka publikuar këtë raport duke thënë se “Kosova renditet e 4-ta në botë për përmirësim nga viti në vit nga viti 2022 në 2023”. Ai ka shkruar se ky raport është një dëshmi më shumë se progresi demokratik dhe ekonomik në Kosovë ecin paralelisht, duke e bërë vendin një destinacion lider për investitorët e huaj. “Një dëshmi më shumë se progresi demokratik dhe ekonomik në Kosovë ecin paralelisht, duke e bërë vendin tonë një destinacion lider për investitorët e huaj”, ka shkruar Kurti në “X”.

Shkelja e të dhënave personale, AIP shqipton gjobë ndaj kompanisë KESCO

PRISHTINË, 19 GUSHT - Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) ka shqiptuar gjobë ndaj Kompanisë Kosovare për Furnizim të Energjisë Elektrike Sh. A (KESCO).

AIP ka bërë me dije se gjoba ka të bëjë me mosndërmarrjen e masave të nevojshme të sigurisë për ruajtjen e të dhënave personale gjatë shpërndarjes së faturave për qytetarët.

Në njoftimin për medie të AIP-së është thënë se gjoba ka ardhur pasi disa qytetarë janë ankuar për shkelje të të dhënave personale nga kjo kompani në procesin e shpërndarjes së faturave.

“Agjencia për Informim dhe Privatësi ka pranuar disa ankesa nga qytetarët (subjektet e të



dhënave) lidhur me veprimin se KESCO ka shpërndarë faturat mujore për shpenzimin e energjisë elektrike duke mos i aplikuar

masat e sigurisë dhe duke u lënë qasje personave të paautorizuar në të dhënat personale të konsumatorëve. Gjatë shqyrtimit

të ankesave, AIP ka konstatuar se KESCO ka dështuar t’i zbatojë masat e sigurisë për t’i mbrojtur të dhënat personale të qytetarëve, duke shkelur kështu detyrimet e saj ligjore”, është thënë në njoftimin e agjencisë.

AIP ka treguar se paraprakisht ishte ndërmarrë një fushatë vetëdijesuese për këtë çështje. “Veprimi i Agjencisë për shqiptimin e gjobës ndaj KESCO është ndërmarrë pas fushatës ndërgjegjësuere që Agjencia ka zhvilluar në muajin shkurt të vitit 2024, me të gjitha kompanitë që bëjnë shpërndarjen e faturave, me ç’rast ka kërkuar zbatimin e detyrimeve ligjore që këto kompani kanë ndaj

konsumatorëve. Me qëllim të përgatitjes së kushteve, Agjencia ka kërkuar nga kompanitë që deri më 30 qershor 2024 t’i ndërmarrin të gjitha masat për ta siguruar mbrojtjen e të dhënave personale. Siguria e të dhënave personale është një e drejtë themelore e qytetarëve dhe mbrojtja e këtyre të dhënave duhet të jetë prioritet për çdo kompani që i përpunon të dhënat personale”, është thënë në njoftim.

Agjencia për Informim dhe Privatësi ka bërë me dije se do ta vazhdojë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nga kompanitë private dhe institucionet publike për ta siguruar mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve.

Kosova edhe këtë vit mori pjesë në Kampionatin Botëror të Lëvrimit

Prishtinë, 19 gusht - Edhe këtë vit Kosova ka marrë pjesë në Kampionatin Botëror të Lëvrimit, në mesin e 40 vendeve nga e gjithë bota, i cili kësaj radhe është mbajtur në qytetin Tartu të Estonisë. I pranishëm në këtë kampionat ka qenë edhe ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), Faton Peci, i cili nga afër ka përcjellë garat në këtë kategori.

Në njoftimin e BPZhR-së, ministri Peci ka pasur një takim

të frytshëm me ministren e Punëve Regjionale dhe Bujqësisë të Estonisë, Piret Hartman, me ç’rast kanë diskutuar për bashkëpunimin dypalësh në fushën e bujqësisë, shkëmbimin e përvojave dhe përmirësimin e politikave për ta mbështetur bujqësinë dhe sektorët e saj, por gjithashtu edhe çështje me interes politik. “Kosova ka nevojë për përvojën estoneze në digjitalizim dhe integrimin e plotë të tij në prodhimtari. Ky

takim është një hap i rëndësishëm drejt forcimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Estonisë. Dy vendet ndajnë vlera të përbashkëta dhe ballafaqohen me sfida të natyrës së njëjtë, përfshirë edhe ato të sigurisë”, ka thënë Peci.

Në fund të takimit të dy ministrat janë pajtuar që bashkëpunimin në mes të dy vendeve mike ta formalizojnë me nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet dy ministrive.



“George F. Kenan: Memoare 1925 - 1950” (1)

Rreziku rus dhe objektivat e ideologjisë pansllaviste



Shkruan:
Prof. dr. Agim ZOGAJ

George F. Kenan i kishte takuar plejadës së intelektualëve amerikanë të cilët, gjithnjë kishin kërkuar qasje më fleksibile politike të ShBA-ve në rrjedhat e politikës botërore në vitet e para të Luftës së Ftohtë. Ai kishte specializuar për të ashtuquajturën “ çështje, hapësirën ruse”. Në vitin 1933 kishte shkuar në Moskë si anëtar i ekipit të Bulltit. Ishte dëshmitar i spastrimeve të mëdha të Stalinit, personalisht në Pragë kishte përjetuar hyrjen e trupave të Hitlerit dhe okupimin e Çekoslovakisë, kurse në Berlin atë e gjen shpallja e luftës për Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga ana e Hitlerit. Nga viti 1944 deri në vitin 1946 sërish ishte në mision diplomatik në ambasadën amerikane në Moskë, si një nga bashkëpunëtorët më të afërt të ambasadorit Harriman. Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, Stalini e impononte Rendin e Ri Botëror, i cili në esencë ishte “pansllavizimi, i përforcuar nga ideologjia komuniste”. Stalini, veçmas pas Konferencës së Postdamit po impononte vullnetin e tij në Evropën Lindore, ndërkohë që e hodhi poshtë bashkëpunimin e pasluftës me ShBA-të. Derisa qarqet më të larta politike në Uashington shqyrtonin raportet me Bashkimin Sovjetik, me qëllim që të eventualisht të kundërshtonin ekspansionin sovjetik, George F. Kenan, aso kohe diplomat relativisht i ri në ambasadën amerikane në Moskë e kishte dërguar një raport diplomatik nga Moska i cili raport ndikoi në riformulimin e pikëpamjeve të administratës amerikane për zhvillimet në botë. Ai raport, më vonë u bë i njohur në historinë e diplomacisë së jashtme amerikane si “Telegrami i Gjatë”. (George F. Kenan, “Long Telegram” nga Moska, 22 shkurt 1946, në Foreign Relations of the United State, 1946 (Uashington, D. C.: U. S. Government Printing Office, 1969) vëll. VI, f. 666 – 709 Kenan, sipas vlerësimeve të Henry Kissingerit ishte i mendimit se “Shtetet e

Bashkuara duhet të pushonin së bëri veten me faj për papajtueshmërinë sovjetike; rrënjët e politikës së jashtme sovjetike janë thellë në vetë sistemin sovjetik”. Pra, Kenan, siç do të shihet edhe nga fragmentet kryesore, të raportit të datës 22 shkurt 1946 argumentonte se, “ politika e jashtme sovjetike ishte një amalgamë e dëshirës ideologjike komuniste me ekspansionizmin e vjetërsuar carist”. Kenan ngulte në qëndrimin se “në konceptin e botës, Stalini në zemër kishte ideologjinë komuniste. Stalini, vendet perëndimore i shihte si armiq të pandreqshëm”. Ndërkaq në takimin (1945) me disidentin jugosllav, Milovan Gjilas, Stalini tekstualisht i kishte thënë” Në qoftë se sllavët qëndrojnë të bashkuar dhe ruajnë solidaritetin, asnjëri nuk do të luajë dot as gishtin në të ardhmen”! Ishte fillim i Luftës së Ftohtë, e cila paralajmërohej edhe nga “Telegrami i Gjatë” i George F. Kenan dërguar nga Moska. Në fakt, njohësit e diplomacisë sekrete të periudhës pas Luftës së Dytë Botërore, me të drejtë vlerësojnë se, pa kujtimet e George F. Kenan, fragmente, të cilave për herë të parë në gjuhën shqipe botohen vetëm përmes “Epokës së Re”, nuk mund të kuptohen të gjitha fshehtësitë diplomatike që shpejtuan fillimin e Luftës së Ftohtë si dhe shkatërrimin e komunizmit si projekt, në radhë të parë si ideologjik, botëror. Por, duke i hedhur një vështrim kritik, përqesimit të hapur të marrëdhënieve të sotme midis Perëndimit dhe Ruisë, në fakt botës sllave, jo vetëm pushtimit rus të Krimesë dhe invazionit të Ruisë ndaj Ukrainës, është e qartë se, cilat janë objektivat e politikës ruse, pansllaviste edhe në shekullin e XXI. Prandaj, udhëheqjet shtetërore në Shqipëri dhe në Kosovë, kanë mundësi që, përmes këtij fejtani ekskluziv, të reflektojnë për zhvillimet, shumë të rrezikshme për sigurinë e rajonit, pra, edhe për çështjen shqiptare dhe pretendimet serbo-ruse.

RUSIA, DIÇKA NDRYSHE DHE KREJT TJETËR

Cilat janë themelet e ekspansionit rus?

Së bashku me pranverën, më në fund edhe paqja arriti në Rusi; kurse i huaji i cili jeton këtu, i lodhur me luftën dhe me dimrin

rus, dëshiron pa masë që sezona e re politike të mos jetë e ngjashme në verën ruse. Prej atyre dy ngjarjeve, me ardhjen e paqes dhe ardhjen e pranverës, i dyti dukshëm imponohet, vërehet në skenën moskovite. Përfundimi i luftës nuk i sjellë ndryshime të mëdha popullit, i cili nën kushtet e luftës, pa pushuar, pa ia ndaluar, qoftë luftë ose paqe, ka jetuar tridhjetë e një vjet. Derisa forcat e mëdha aleate ngelin në Evropë, Stalini nuk ka për qëllim të fillojë demobilizimin e legjioneve të veta. Madje edhe kur armatat aleate të shkojnë, ai do ti duhet, për shkak të politikës së përgjithshme me qëllim të forcimit të pushtetit në territoret e sapofituara, edhe më tej të mbajë fuqinë e madhe të armatosur dhe të drejtë energjinë nacionale në ndërtimin e fuqisë ushtarake. Dhe së fundi, gjendja e domosdoshme mobile është element i domosdoshëm i shtetit policor. Nga kjo, mund të presim që për një periudhë të ardhshme të pa caktuar me jetën e popullit rus edhe më tej do të udhëheq nevoja që të prodhohet dhe të bartet arma. Edhe në aspektin e jashtëm të jetës ruse, në të cilën ai fakt ka pasur rëndësinë dominante më shumë se tre shekuj, nuk guxon të priten kurrfarë ndryshime të afërta. Mirëpo, pavarësisht në pamjen, dukjen e jashtme, përfundimi i luftës duhet të sjellë ndryshime të mëdha në rrethin në të cilin Rusia duhet të jetojë. Për këtë arsye, ardhja formale e paqes në Perëndim ofron kushte të volitshme për vlerësimin e pozitës së Ruisë përgjithësisht; pozitë kjo deri te e cila ka ardhur përmes sfidave të luftës dhe invazionit dhe prej nga i duhet nisur në ardhmërinë më të pasigurt dhe të turbullt me të cilën ndonjëherë më parë populli rus është ballafaquar. Ndryshimi më i madh të cilin lufta ia solli pozitës së Ruisë në botë nuk ka dalë, buruar nga zhvillimi i vetë Ruisë, por nga dezintegrimi i forcave të popujve fqinjë. Potenciali i gjithmbarshëm i Risisë, sigurisht se pak është ndryshuar nga viti 1940. Humbjet në forcat materiale dhe njerëzore në esencë i ka komentuar forca e re e detyruar e robërve gjerman dhe e qytetarëve të territoreve e të pushtuara, disiplinimi i ashpër i shoqërisë ruse, përdorimi i gjerë i forcës punuese të femrave dhe zhvillimi i territoreve të reja industriale. Mirëpo forcat konkurren

tare të cilat qëndrojnë përballë Ruisë, përtej kufijve të saj tokësor kanë përjetuar rënie të rëndësishme. Kur të mbaroj lufta në Lindjen e Largët, Rusia për herë të parë në historinë e saj nuk do ta ketë më asnjë kundërshtar të madh në masën e territorit të Euroazisë. Ajo gjithashtu do ta ketë pushtetin fizik, mbi ato hapësira të pabanuara; kurse në mesin e atyre hapësirave ka edhe të atilla në të cilat pushteti rus kurrnjëherë nuk është vendosur, zgjeruar. Ato hapësira të reja (edhe pse kufijtë e tyre të saktë qëllimisht nuk po bëhen publik) sigurisht se do të përfshijnë më shumë se 100 milion frymë – prej të cilëve më së shumti në pjesën evropiane. Këto ndryshime janë me rëndësi të madhe për zhvillimin e shtetit rus.

Rusia kishte pretenduar edhe territore perëndimore

Kuptohet, rritja e tillë relative e pushtetit rus do të bie deri te rritja e ngjashme e detyrimeve, obligimeve të saja. Tani Ruisia do të detyrohet që para botës të bartë së paku përgjegjësinë morale për fatin, lumturinë dhe përparimin e popujve të sapopushtuar, për zhvillimin e resurseve të tyre, rregullimin e marrëdhënieve prodhuese e shoqërore, sigurimin e mbrojtjes së tyre ushtarake. Mirëpo, kjo edhe nuk është detyrimi më i madh. Qeverisja, administrata ruse tani e ka një obligim, detyrim të rëndë ndaj vetvetes: pra, që territoret e fituara t'i mbaj të nënshtruara. Kjo, sepse s'ka dyshim se, shumë popuj të nënshtruar nuk do ta durojnë dhe do ta urrejnë pushtetin, administratën ruse. Kurse kryengritjet e tyre të suksesshme kundër administratës, qeverisë së Moskës do të mund të dridhnin tërë fuqinë ruse. Çështje e madhe e pozitës së re të Ruisë, shikuar nga Moska, konsiston në faktin nëse shteti rus është e aftë që me sukses ti bartë, përballoj detyrat e reja, të forcojë pozitën e vet mbi këta popuj, marrë në përgjithësi ti harmonizoj me strukturën tradicionale politike të popullit rus, dhe që nga pushtimeve të saja të krijojë burimet e forcave të reja dhe jo të dobësohet. Kjo, ashtu siç shihet nga Kremli është çështja e parë e ardhmërisë ruse. Në themel të ekspansionit tradicional rus shtrihet ndjenja shekullore e pasigurisë te një populli i cili ishte i rrethuar me popujt nomad luftarak. Tani shtrohet pyetja, nëse ajo domosdoshmëri, e cila tani është

bërë shenjë e përhershme e psikologjisë ruse, do të ofroj bazën për ekspansionin e suksesshëm të Ruisë në këto territore të reja në lindje dhe në perëndim? Dhe, nëse këtë ekspansionin e ka filluar me sukses, a do të di Rusia se kur duhet ndërprerë atë? A mos atë, natyrën e saj do ta shpie në luftën që të sundoj me tërësinë – që plotësisht t'i pushtoj, sundoj brigjet e Atlantikut dhe të Pacifikut? Nuk duhet harruar se Rusia kishte tentuar të absorbonte territoret perëndimore, prapa kufijve etnikë rusomadh, bjellorus dhe ukrainas, mirëpo në këtë nuk kishte pasur sukses. Hulumtuesit, studiuesit e historisë ruse tepër pak i kanë kushtuar kujdes lidhjes midis revolucionit rus dhe politikës ekspansioniste cariste në perëndim në shekujt tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë. Pushtimi i provincave baltike nga ana e Petrit të Madh nuk kishte nxitur kurrfarë vështirësi gjatë një shekulli e gjysmë, duke i falënderuar asaj se Petri me shkathësi ishte përmbajtur që ti kufizojë kompetencat e pushtetit të atjeshëm dhe që të përzihet në gjuhë, doke, zakone ose në strukturën shoqërore të provincës. Derisa kishin sunduar parimet e durimit dhe sjelljet e mira nga shekulli tetëmbëdhjetë, madje as Polonia nuk kishte nxitur, shkaktuar telashe më të mëdha. Shteti rus tani, në periudhën e shkurtër prej dy dekadave, në të shumtën e ka përsëritur historinë e dy shekujve të kaluar të carizmit. Për dhjetë vitet e para, të sundimit të tij Stalini përsëri e ka ngjallur kohën e Petrit të Madh. Në fillim të luftës në Evropë ai tani më jeton në fuqinë, sundimin e Ruisë në stilin e madh të Katarines II. Fundi i luftës e gjen në pozitën e cila është e ngjashme pozitës së Aleksandërit të Parë dhe periudhën e fundit të Napolonit. Kur shpirti, fryma e Nikolës tani është prezent në pushtetin glomaz dhe të ashpër të policisë ruse, në shumë qëllime dhe veprime të politikës ruse... Nëse ky krahasim qëndron, atëherë mund të presim se po mbillet fara e një grci të ri, ashtu siç janë farat e revolucionit rus që i kishin mbjellë ata para gati 100 vjete para se ai revolucion të ishte shfaqur. Dhe nëse një histori e tillë e kondensuar vazhdon, për pesë ose dhjetë vjet atëherë Rusinë serish do të duhej ta mbulonin të njëjtat re të dezintegrimit shoqëror të cilat e kanë errësuar qiellin rus në fillim të këtij shekulli. *(Vijon në faqën 10)*

George F. KENAN: Memoare 1925 - 1950 (2)

Rrezikshmëria nga imperializmi rus

Popujt e shtypur e njohin fytyrën e pushtetit marionet - rus

Shkruan:
Prof. dr. Agim ZOGAJ

Rusia sovjetike, si fuqi imperialiste, ka burime të mëdha të forcave. Ajo ka qasje të drejtpërdrejt në territoret të cilat i ka nënshtruar, qasje të cilën Gibboni e mendon si një nga parakushtet në mënyrë që me sukses të kryhet detyra e shtëpisë që popujt e largët të mbahen në nënshtrim. Ajo disponon me përparësitë të cilat regjimit diktatorial, në realizimin, zbatimin e sundimit policor, i ka sjellë zhvillimin e armëve bashkëkohore teknike – përparësi me të cilat popujve të robëruar, nënshtruar iu kanë pamundësuar kryengritjen kundër fuqisë gjermane në luftën e kaluar. Dhe së fundi, Rusia Sovjetike e ka burimin e saj më të madh dhe më të fuqishëm në shkatërrimin e përgjithshëm të tendencave kundërshtare politike si dhe në dezorientimin e përgjithshëm në shpirtin e popullit. Që nga shkatërrimi, rënia e shtetit gjerman, lëvizja me të cilën udhëheq Moska sipas energjisë së saj, iniciativat, disiplinën, njëtrajshmërinë dhe pamëshirshmërinë nuk ka shembull në mbarë pjesën e Evropës. Ndërsa është vështir të ndalet çfarëdo lëvizje politike e cila udhëheq, prin në të gjitha ato aftësi, veçori.

Mirëpo, pavarësisht gjithë kësaj, mekanizmi rus në Evropën Lindore dhe ate të Mesme i ka edhe dobësitë e veta.

Në radhë të parë, e ka mangësinë e paevitueshme të sundimit të të huajit. Popujt e atyre territoreve tani e njohin

fytyrën e pushtetit marionet. Aty është vështir që dikush ti mashtrojë pas përvojës me gjermanët. Moska do të dëshironte që ata të cilët e pranojnë pushtetin e saj, dhe vullnetin e saj tua përcjell popujve të vet, të veprojnë, paraqiten si forca të pavarura patriotike të atyre popujve. Por kjo është përpjekje e kotë. Evropa nuk i ka humbur së koti pesë vite për të gjetur kuislingët dhe kolaboracionistet; sot, kujtdo qoftë i është vështirë t'i fshehë ose maskojë punën e vet në shërbim të një shteti të huaj.

Për popujt jorus ndoshta agjentët e dikurshëm të Kominternes në mesin e tyre ishin tradhtarë; mirëpo ata ishin tradhtarë të hapur dhe të rëndësishëm, në emër të një besimi e cila në zbatimin e saj asgjë më pak nuk është universale nga krishterimi, besim ky i cili me një arsyetim të mirë mund të proklamohet se në zemër i janë interesat e të gjithë popujve, edhe të mëdhenjve edhe të vegjëlve. Mirëpo në ata të cilët sot i marrin detyrat e realizimit të urdhrave nga Kremlini duhet të bie dyshimi se para së gjithash dhe mbi të gjitha, në zemër u janë interesat e popullit rus; edhe pse ata janë pjesëtar të popullit të cilët kanë rënë nën sundimin, pushtetin rus, nuk u është e lehtë te shtëpia që të paraqiten në rolin e shpëtimtarit të popujve të vetë. Ai i cili mendon se shpëtimi nacional mund të vjen vetë, përmes sundimit të tjerëve, popullit më të madh, në disa raste mund të jetë njeri largpamës. Mirëpo, nuk mundet lehtë të bëhet person i popullarizuar.

Politika ruse në territoret e pushtuara

Implikimet e këtij fakti themelor janë edhe më të

ashpra për shkak të valës së shovinizmit dhe arrogancës e cila, duke ju falënderuar kësaj lufte dhe fitoreve ruse, e ka marrë shikimin real në armatën sovjetike dhe burokracinë. Kjo, imperializmit rus i ka dhënë ashpërsi të tillë e cila nuk mund të jetë e llogaritur në nxitjen e besimit dhe besimit në zemrat e huaja. Rasisë, në një kuptim më mirë i kanë shërbyer fanatikët e guximshëm të Kominternes të cilët në ditët e hershme të pushtetit sovjetik popujve të tjerë u kanë sjellë flakadanin e socializmit revolucionar se sa ata gjeneral arrogantë dhe komisarë të cilët sot sundojnë në kryeqendrat e Evropës së mesme dhe të cilët nuk kanë më pak ambicie dhe instinkt dhune si dikur para 100 vjet satrapët carist.

Gjithë kësaj duhet shtuar edhe faktin e mjer se, politika sovjetike në territoret e pushtuara nuk është shumë e pasur sipas përmbajtjes konstruktive nga politika e partnerëve sovjetik. Ndoshta është më e fuqishme për nga disiplina dhe energjia. Mirëpo, pas veti nuk ka kurrfarë ide të madhe me të cilën popujt e ndryshëm të atij territori do të frymëzoheshin dhe mes veti do të lidheshin në një epërsi unike politike me një qëllim të përbashkët. Marskizmi i pastër është vjetërsuar; nëse fryma e tij e zjarhtë edhe më tej e përshkon në masë të caktuar pushtetin e Kremlini, rusët nuk provojnë, tentojnë ta përdorin si program të drejtpërdrejt politik në Evropën Lindore. Meqenëse kjo u mungon, ata nuk disponojnë me kurrfarë mendim gjithëpërfshirës konstruktiv me të cilin do të mund të paraqiteshin, prandaj thirrjet e tyre deri më tani nuk kanë hasur në përkrahje.

Thirrja, Ftesa në qerim drastik

të hesapeve me ata të cilët janë të akuzuar për bashkëpunim me gjermanët, në rastin më të mirë ka ndihmuar përkohësisht dhe jo aq sa për të ushqyer besimin ose entuziazmin. Edhe këtë njerëzit shpesh ndjejnë se rusët i keqpërdorin me qëllim që nga skena t'i largonin elementet të cilët sigurisht se do të qëndroni si pengesë qëllimeve të tyre politike.

Së fundi, me arsye mund të pyesim nëse Bashkimi Sovjetik është i aftë që pa ndihmë nga vendet evropiane të ringrit dhe ta rregulloj jetën ekonomike të atyre popujve në mënyrën që kishte me u quajtur e suksesshme. Me termin “ të suksesshme” nënkuptojmë aso mënyrë e cila do të mundësonte që popujt për të cilët është fjala të pajtohen me dominimin e përhershëm sovjetik.

Rusi është fatalist

Sipas të gjitha arsyeve të mundshme, mund të parashikohet se, rusët në territoret e sapopushtuara, edhe më tej do t'i japin përparësi politikës dhe jo ekonomisë, pavarësisht se sa kjo kushton. Ata nuk do të hezitojnë ta shkatërrojnë produktivitetin e degëve të tëra të jetës ekonomike, nëse me këtë do ti detyrojnë në varësi dhe në pafuqi elementet të cilat përndryshe do të mund t'i kundërviheshin pushtetit të saj. Në rënien e standardit jetësor, i cili do të paraqitet nga këto situata, ata në shumicën e fakteve do të shohin mundësinë për ta disiplinuar pjesën mikroborgjeze të popullit përkatës; ata do të revoltohen pse ata popuj nuk dëshirojnë të pajtohen me standardin jetësor si te popujt sovjetik. Mirëpo, nga ana tjetër ata gjithashtu do të synojnë – për shkak të prestigjit dhe sigurisë

ushtarake – të zhvillojnë deri në maksimum degët e caktuara prodhuese të cilat në veçanti janë të rëndësishme për shtetin; dhe do ti zgjedhin ato dukuri në ekonominë e botës së jashtme të cilat mund të jenë të dobishme me qëllime propagandistike në vend dhe jashtë me qëllim për të treguar se si pushteti sovjetik do të ishte ekonomikisht më i fuqishëm, më i begatshëm. Ata do të forcojnë zhvillimin e të gjitha industrive të cilat shërbejnë mbrojtjen e shtetit. Për këtë qëllim do të investojnë më shumë energji. Nëse nuk i marrim parasysh degët prodhuese për nga rëndësia jetësore për politikën e brendshme dhe sigurinë e jashtme të shtetit, kujdesin më të madh do t'i japin, kushtojnë kontributit në planin e politikës së jashtme, dhe jo përmbajtjes së vërtet ekonomike. Rusët janë popull i regjisorëve të teatrove; dhe thellësisht besojnë që çështjet nuk janë ashtu si janë, por ashtu si duken. E zbatuar tek rusët dhe për rusët, kjo rregull vlen deri në pikën e caktuar. I ballafaquar me bukën dhe me lojërat, rusi e pranon argëtimin me falënderim, kurse është fatalist në çështjen e sasisë së bukës. Nëse merr ndonjë lëmoshë të papritur, ai atë e fut me gëzim në xhep; as nuk befasohet as nuk reagon nëse serish ia merrni. Dhe për nga natyra ai kujdeset për atë që në çdo kohë të shpreh atë përshtypje të cilën shteti ka dashur ta nxisë me atë shfaqje të zemërgjerësisë. Ashtu, jeta është më e sigurt dhe më e qetë.

Mirëpo, është çështje tjetër nëse një veprim i tillë do të ketë sukses tek popujt jorus. Sigurisht se nuk do të funksionojë aq mirë dhe ky do të jetë një nga problemet serioze me të cilat rusët do të ballafaqohen. (Vijon në faqën 11)

George F. KENAN: Memoare 1925-1950 (3)

Si do t'i mbajë Rusia territoret dhe popujt e pushtuar?



Shkruan:
Prof. dr. Agim ZOGAJ

Kremlini nuk mund të nxisë më shpresat, besimet idealet

Rusët për asnjë çast nuk do të heqin dorë që për qëllime politike të shërbehen me armët ekonomike, pavarësisht se kjo do t'ju kushtoj. Duhet përmendur ndoshta edhe vështirësinë më të madhe me të cilën rusët do të ballafaqohen në drejtimin, udhëheqjen me territoret e sapofituara. Fjala është për kuadrot dhe forcës punuese. Në perëndim, Finlanda, Estonia, Latvia, Litva, Polonia, Gjermania nga Odra deri në Nise, Rutenia dhe Sllovakia, Hungaria, Rumania, Bullgaria dhe Jugosllavia bashkërisht kanë afro 95 milion banorë. Këtu nuk janë futur Çekia dhe Moravia, dhe Austria, ku rusët dukshëm synojnë gjithashtu të kenë ndikim. Asnjë nga këta popuj nuk bie në grupin gjuhësor rus, dhe prej tyre vetëm rreth 60 për qind flet gjuhë sllavene. Për t'u mbajtur të nënshtruar ata anëtar të detyrueshëm dhe për t'u nënshtruar sigurisht se do të jetë e nevojshme kuadër më i madh policor dhe administrativ sa ai që ishte i nevojshëm në kohërat normale; dhe ai duhet të përbëhet nga një milionë njerëz.

Këtu rusët gjenden para dilemës. Nëse mbështeten gjerësisht kuadrot lokale, i nënshatrohen rrezikut që posa t'i tërheqin forcat e veta ushtarake të vijë deri te pakënaqësia, humbja e kontrollit. Nëse në vendin e tyre vendosin njerëzit e tyre, menjëherë do të paraqiten një varg vështirësish. Në radhë të parë, nuk kanë mjaft njerëz të cilët do të dinin gjuhët dhe doket e popujve të tjerë. Nëse tentojnë të mbajnë numrin më të madh të njerëzve të vet për kohë të gjatë jashtë vendit, atëherë rrezikojnë që ata njerëz të prishen nga interesat e ndryshme, jetës më të mirë dhe atmosferës më tolerante. Mund të përpigjen ta evitojnë këtë rrezik, me atë që do t'i mbajnë në grumbull në bashkësitë e kontrolluara sovjetike dhe që do t'ju ndalonin çfarëdo takim të afërt të pakontrolluar me popullatën vendase, ashtu siç tani veprojnë me diplomatët e tyre në botën e jashtme. Ose mund t'i dërgojnë në

botën e jashtme vetëm për një kohë të shkurtër. Mirëpo, as në rastin e parë e as në të dytin njerëzve të tillë nuk është lehtë t'u ngulitesh njohjen e plotë të gjuhës së huaj dhe mënyrën e mendimit e cila u është e domosdoshme nëse duhet të jenë administrator të mirë. Administrata sovjetike në këtë pikë gjendet para problemit me të cilin ballafaqohen të gjithë linguistët: kjo, se njeriu vërtet nuk mundet thellë ta njeh gjuhën dhe kulturën e ndonjë vendi të huaj dhe që me këtë rast edhe vet të mos bëhet pjesë e atij vendi dhe që të mos i merr edhe veset e atij vendi, atij populli. Ky fakt, veçmas shqetëson administratën sovjetike. Qytetari mesatar sovjetik, të cilin që nga fëmijëria e edukon rendi i pagabuar propagandistik i shtetit, nuk është mësuar që të mendojë në mënyrë të pavarur dhe as që ka mjaft sens për përgjegjësi.

Zjarri i marksizmit revolucionar është shuar

Në këtë pikë i jemi afruar një fakti mjaft të rëndësishëm dhe shumë pak të njohur në shkallën e tashme të zhvillimit të Rusisë. Fjala është për atë, se në çfarë mase administrata e ka humbur pushtetin moral mbi masat e popullatës, banorëve rusë. Këtë po e përmendi me një frikë, shqetësim, sepse nga kjo mund të dalin konkluzione të gabuara të natyrës shumë serioze. Pra, kjo nuk do të thotë se në Rusi ekziston ndonjë pakënaqësi serioze. Kjo nuk do të thotë se njerëzit nuk duan të punojnë atë që Kremlini kërkon prej tyre. Kjo nuk do të thotë se ata me gjithë gojë do të falënderojnë sloganin, parullën të cilën e ka hedhur, futur shteti. Së fundi, kjo nuk do të thotë se shumë prej tyre vërtet nuk mburren dhe nuk entuziazmohen me ato tradita nacionale dhe aspiratat në mbrojtës në të cilin Kremlini tani më është shndërruar. Por, kjo do të thotë se në popullin rus nuk ka më shumë iluzione për kualitetet morale dhe shpirtërore të gjithë asaj që paraqet shteti. Zjarri i marksizmit revolucionar përfundimisht është shuar. Ajo që ngel nga ai mund të nxitë patriotizmin dhe ndjenjat nacionaliste, edhe me qëllim të mbrojtjes por edhe me qëllim të ekspansionit imperialist. Por nuk mund ta nxisë atë fond të idealizmit përfundimtar njerëzor të cilin ndonjëherë ka mundur ta nxisë revolucionin, ashti siç kanë ditur ta bëjnë këtë, kishat në cilën do kohë. Kremlini më nuk mund t'i nxisë besimet më të thella, shpresat më intime, idealet më profitabile...

Përkundër kësaj, kur sot banorët gojarisht njoftohen se është caktuar ndonjë shërbim i rëndësishëm fetar, njerëzit i mbushin kishat dhe madje edhe tërë kuartin e qytetit në atmosferë të ngazëllimit. Partia le t'i thërret anëtarët e vet dhe madje edhe qytetarët tjerë sovjetik në demonstrata në cilën do kohë, në cilin do numër dhe në cilën do formë. Ata do të paraqiten pa diskutim, do të bartin secilin transparent i cili ju vihet në grusht dhe do ta kryejnë cilëndo detyrë që ju jepet. Mirëpo, Partia më nuk mundet që në mesin e tyre të krijojë as hijen e atmosferës të ngazëllimit të vërtet dhe përjetimit i cili ishte lexuar në fytyrat e dhjetëra mijëra njerëzve me rastin e natës së Pashkëve në Moskë. Partia ka arritur të mbajë atë që është mbretërore; mirëpo veprimi i saj fillestar që të mbajë, përfshijë edhe atë që është hyjnore është hedhur qetë dhe vendosmërisht.

Kontrolli mbi popujt jo rus

Tani për tani, dhe madje edhe për dekada të cilat do të vijnë, kjo ndoshta nuk do të ketë ndonjë domethënie të madhe, të dukshme, praktike. Mirëpo paraqet mundësinë me të cilin shteti mund të llogarisë. Burimet e fanatizmit i janë shmangur kontrollit shtetëror. Deri atëherë kur Kishës t'i lejohen vetëm rrugët e pa rrezikshme dhe deri atëherë kur me kurrfarë forca tjera nuk lejohet të prekin në ato segmente të natyrës njerëzore dhe të pushtetit njerëzor, deri atëherë nuk ka rreziqe. Mirëpo nëse kurdoherë i përfshinë dhe i aktivizon ndonjë ndikim nga jashtë, regjimi do të gjendet në rreziqet të mëdha, të paparashikueshme. Prandaj mu për këtë është më e madhe nevoja që masat sovjetike të izolojnë nga ndikimi, prekja nga jashtë. Dhe me këtë problemi i kontrollit mbi popujt jorus bëhet edhe më delikat se kurdoherë më parë. Pra, marrë në përgjithësi shihet se Rusia nuk do ta ketë të lehtë ta mbaj pushtetin të cilin e ka vënë ndaj popujve të Evropës së Mesme dhe asaj Lindore, vetëm nëse nuk merr ndihmë materiale dhe morale nga Perëndimi. Prandaj politika ruse në periudhën e ardhshme do të synojë që t'i afrojë, bëjë për veti popujt e Përqendrimit, dhe veçmas Shtetet e Bashkuara të Amerikës: 1) që të përkrasin dhe legjitimojnë dominimin rus në ato territore në mënyrë që shtetet marionete ruse do t'i pranojnë për vende të pavarura dhe ndaj tyre do të sillen si ndaj të tillave, kurse në këtë mënyrë së bashku me qeverinë sovjetike do të mbrojnë gënjeshtren për karakterin e

pushtetit në ato vende, dhe 2) që Rusisë t'i ndajnë ndihmë të gjerë materiale e cila pushtetit sovjetik do t'i mundësoi të kompensojë dëmet ekonomike të cilat i ka shkaktuar me programet e shtrenjta, kryesisht politike dhe që vetit t'ia përshkruaj meritat pse popujve përkatës u ka sjell edhe përparimin ekonomik dhe jo vetëm përparimin politik.

Nëse në shikim të parë duket e çuditshme nëse Kremlini mund të shpresonte në përkrahjen e popujve demokratik për qëllime të kundërta idealeve të demokracisë perëndimore, duhet kujtuar se rusi ndaj të gjitha zhvillimeve të ndjenjave publike sillet si marinar ndaj erërave. Ai beson, se nëse nuk mund të notoj drejtpërdrejt kundër tyre, atëherë së paku mund të shfrytëzojë fuqinë e tyre që të drejtohet në drejtimin e kundërt të përgjithshëm, të kundërt nga drejtimi nga ato erëra që fryjnë. Atij nuk i duket e pamundur që entuziazmi, ngazëllimi i Perëndimit për demokraci dhe pavarësi nacionale të shfrytëzohet për të shtyrë interesat e autoritarizmit dhe për nënshtrimin e popujve tjerë. Ai di, që të shërbehet me një shprehje klasike, se “ me njerëzimin sundojnë fjalët e thjeshta”.

RUSËT LUFTOJNË PËR TERRITORE

Oferta amerikane dhe refuzimi rus

Më tej, sa i përket ShBA-ve, Kremlini llogarit në disa faktor të caktuar psikologjik për të cilët di se me të madhe do të veprojnë në dobi të Rusisë. Ai di se opinionin, publiku amerikan është i mësuar të besojë:

a) se bashkëpunimi me Rusinë, ashtu sikur e mendojmë ne, është krejtësisht e mundur; b) se varet vetëm nga vendosja e marrëdhënieve personale, të përzemërta dhe të besueshme me udhëheqësit rus; dhe c) se nëse ShBA-të nuk gjejnë mënyra për të siguruar atë bashkëpunim (sërisht nëse ne e paramendojmë), atëherë lufta e kaluar është udhëhequr kot, kurse lufta e re është e paevitueshme dhe civilizimi gjendet para katastrofës së plotë).

Kremlini e di se asnjë nga këto konstatime nuk është i drejtë. E di se qeveria sovjetike, për shkak të strukturës së veçantë të strukturës të pushtetit të vet, teknikisht është e pa aftë të bashkëpunojë me qeveritë tjera në mënyrën se si amerikanët e kanë ndermen kur të flasin për bashkëpunimin. E di se policia e fshehtë sovjetike nuk

ka kurrfarë qëllime të përkrah ato takime të veçanta midis dy popujve të cilat marrëdhënie do të krijonin bazë të gjerë për besimin reciprok. E di se gjatë 11 vjet të marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve qeveria e SHBA-ve më së paku në 99 për qind të rasteve kishte ndërmarrë iniciativën në mënyrë që në ato marrëdhënie të futeshin besimi dhe përzemërtës, dhe se ato përpjekje thuaja se gjithmonë kanë hasur në dyshim, refuzim, qëndrim jo miqësor; deh se kjo nuk mund të jetë ndryshe as në të ardhmen. Së fundi e di se për paqen e ardhshme botërore aspak nuk është i domosdoshëm ai bashkëpunimi i afërt të cilin synojnë amerikanët. Ai, si organizëm i cili në mënyrë të themeltë është orientuar në realitetin e fuqisë, e di se për hir të sigurimit të stabilitetit midis fuqive të të mëdha për dekadat e ardhshme është e domosdoshme ruajtja e vërtetë e baraspeshës, ekuilibrit logjik midis atyre dhe mirëkuptimi real për interesat vitale, gjegjëse të sferave të interesit.

Mirëpo, qeverisë sovjetike nuk i hynë në llogari që opinionit amerikan t'i thyen ato iluzione të cilat janë shumë të dobishme për interesat sovjetike. Moskës i është për dëshire, vullneti që amerikanët të luhaten në disa iluzione të cilat do t'i shpijnë që në administratën e tyre të bëjnë presion për të bërë edhe të pamundurën dhe që gjithnjë për të shkuar një hap përpara në synimin që të fitojnë përkrahjen e qeverisë sovjetike. Derisa iluzionet e tilla të mund të mbahen në mesin e masave të gjëra të opinionit amerikan, deri atëherë Kremlini nuk do të heq dorë për shpresën se do të mund, që në ato rrethana, të shfrytëzojë demokracitë perëndimore si mjete më të mëdha dhe më të fuqishme për forcimin e pushtetit të vet në Evropën Lindore dhe atë të Mesme.

Pikërisht kjo shpresë fshihet prapa secilit aksionit rus në çështjet e sigurisë ndërkombëtare. Nga organizatat e sigurisë ndërkombëtare Rusia pret që ta mbroj qeverinë ruse në rripin e shteteve marionete. Nga ajo organizatë, ajo pret që në mënyrë automatike të sigurojë ndihmën e demokracie perëndimore kundër secilës forcë e cila do të provonte të çlirojë popujt përkatës. Nisur nga kjo, ajo pret që në formë kredish dhe ndihmë ekonomike menjëherë t'i kthehet zemërgjerësia për faktin pse ka pranuar të hyjë në këtë organizatë.(Vijon)



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Osmani e merr në përkujdesje megakampin stërvitor të organizuar nga Akademia e Basketbollit të Trashëgimisë së Kosovës

PRISHTINË, 19 GUSHT - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka bërë me dije se ka marrë në përkujdesje megakampin stërvitor të organizuar nga Akademia e Basketbollit të Trashëgimisë së Kosovës. Përmes një videoje të publikuar në llogaritë e saj zyrtare në rrjete sociale, Osmani ka thënë se

sporti po vë në pah shkëlqimin e të rinjve tanë ditë pas dite, e kështu po ndodh edhe në basketboll. “Me kënaqësi të veçantë e kam marrë nën patronat mega kampin stërvitor të organizuar nga Akademia e Basketbollit të Trashëgimisë së Kosovës, i cili solli basketbollistë të rinj nga

Kosova dhe ekspertë e trajnerë të basketbollit amerikanë nga NBA në Kosovë, për t’i frymëzuar edhe më shumë talentët tanë t’i arrijnë majat ndërkombëtare suksesit. Sporti po vë në pah shkëlqimin e të rinjve tanë ditë pas dite, e kështu po ndodh dhe në basketboll”, ka thënë Osmani.



Hedhet shorti për edicionin e ri në Ligën e Dytë, Superligën, Ligën e Parë U19 dhe Superligën U17



PRISHTINË, 19 GUSHT - Në ambientet e Federatës së Futbollit të Kosovës të hënën është bërë tërheqja e shortit për edicionin e ri të garave për Ligën e Dytë, Superligën dhe Ligën e Parë të Juniorëve si dhe Superligën e Kadetëve. Në emër të FFK-së, klubeve pjesëmarrëse në gara edicion të mbarë u dëshiroi kryetari i Komisionit të Garave për këto liga, Ardian Llumnica, i cili ka kërkuar nga to të organizohen sa më mirë për mbarrëvajtje të garës.

PAS TËRHEQJES SË SHORTIT NË JAVËN E PARË, TË SECILËS LIGË DO TË TAKOHEN:

Liga e dytë
Tefik Çaga – Sharri
Kosova V – Deçani
Prizreni – Lepenci
Dukagjini – Dielli
Podujeva – Behar
Dardania – Arbëria
Ulpiana – Rilindja
Shqiponjat – Vllaznia

Superliga e juniorëve
Llapi – Trepça
Istogu – 2 Korriku
Vëllaznimi – Podujeva
Trepça’89 – Top Futboll
Ramiz Sadiku – Gjilani
Ferizaj – Vushtrria
Fushë Kosova – Ballkani
Drita – Prishtina

Liga e parë e juniorëve
Dinamo – KEK-u
Drenica – Liria
Flamurtari – Prizreni
Dukagjini – Rilindja

Superliga e kadetëve
Ramiz Sadiku – Ferizaj
Ballkani – Gjakova
Kurda – Trepça’89
Llapi – Trepça
Malisheva – Rilindja
Drenica – Prishtina
Vushtrria – Drita
2 Korriku – Q.S Prishtina

Muriqi: Dikur e shikoja Realin në televizor, tani i shënova gol



MAJORKË, 19 GUSHT - Sulmuesi Vedat Muriqi ka thënë se është krenar që shënoi fol ndaj Real Madridit. Ylli i Kosovës ishte fantastik në barazimin e Mallorcas ndaj kampionit të Evropës, duke shënuar golin e vetëm për vendasit, që ka vlerën e një pike. Pas ndeshjes, Muriqi i cili është zgjedhur edhe lojtari i ndeshjes, është prononcuar

për “La Liga-n”. “Real Madridi është skuadër fantastike. I uroj më të mirat. Dikur e shikoja në TV, tani isha në gjendje të shënoj kundër tij. Nuk kam asgjë përtej respektit për të”, ka thënë Muriqi. Ndër të tjera, Muriqi ka thënë se pas vetëm dy minutave lojë u kishte thënë madrilenëve se janë shumë të shpejtë. “U thashë lojtarëve të Real

Madridit, pas vetëm dy minutave në lojë, se janë shumë të shpejtë. Yje botërorë. Jam krenar që shënova gol kundër tyre”, ka thënë qendërsulmuesi Muriqi. Për Muriqin ky ishte goli i parë për këtë kampion, derisa Mallorca me trajnerin e ri dukej komplet ndryshe, duke luajtur futboll shumë ofansiv me presion të lartë.

Rashica, i lumtur me formën e tij dhe të Besiktasit

BESIKTAS, 19 GUSHT - Milot Rashica ka thënë se është i lumtur me formën që po e shfaq në këtë fillim-sezoni në Superligën turke. Ylli i Kosovës e ka ndihmuar Besiktasin në fitoren 4:2 ndaj Antalyasporit në fundjavën që shkoi. Vushtriasi ka dhuruar dy asistime, fillimisht për Immobilen e më pas për Silvan, ndërsa sulmuesi italian e ka shënuar edhe një gol tjetër, kurse të

katërtin dhe të fundit e ka realizuar futbollisti shqiptar Ernest Muçi. Besiktasi prin në tabelë me 6 pikë duke i fituar të dyja ndeshjet e para sezonale. Dhe, kjo s’ka se si të mos e bëjë të ndihet mirë 28-vjeçar, i cili e bëri një postim në rrjetet sociale. “Dy fitore nga dy ndeshje. Të vazhdojmë kështu përpara”, ka shkruar Rashica në “Instagram”.

Në ndeshjen e parë sezonale, Beshiktasi e kishte mposhtur Samsunsporin në udhëtim me rezultat 2:0. Ekipi nga Stambolli synon ta fitojë titullin e kampionit në Turqi, teksa rivalë kryesorë edhe në këtë sezon do t’i ketë dy gjigantët e tjerë turq, kampionin aktual Galatasaray, ku kishte luajtur Milot Rashica për një vit në formë huazimi, dhe Fenerbahçen.





Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti"Sh.A .Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti"Sh.A .Pejë me datë 20.08.2024, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

KONKURS

Pozita : Puntorë Auto Larje 1 pozitë

Vendi punës Pejë:
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.
Koeficienti i pagës 1.7

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Përgjegjës për larjen dhe pastrimin e automjeteve të kompanisë;

2. Rishikimi i herë pas hershëm i automjeteve, në lidhje me nevojën për të u pastruar;

3. Kontrollimi i automjeteve me material harxhues (vaj, hidrol etj)

4. Kryen edhe detyra tjera shtesë të përcaktuara nga shefi i servisit .

5. Për mos respektimin e pikave te lartecakura i përgjigjet drjtëpërdrejtë, Kryeshefit Ekzkativ.
- a.Kushtet e përgjithshme :

1. Një CV te detajuar

2. Çertifikata që kandidati nuk është nen hetime

3. Letër motivimi

4. Kopja e leternjoftimit

5. Çertifiata mbi gjendjen shendetsoe
- b.Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

•Shkollimin e fillor

•Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;
- Pozita : Zyrtar IT 1 pozitë
- Vendi punës Pejë:
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.
Koeficienti i pagës 3.4
- Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësiive të punës:
1. Mblikëqyr dhe menaxhon të gjitha aktivitetet e IT, përfshirë rrjetin, infrastrukturën e serverëve, “softwerin”, bazën e të dhënave dhe aplikacionet në kuadër të ndërmarrjes;

2. Këshillon dhe mbështetë të gjitha departamentet për nevojat e tyre operative dhe zgjedhjen e problemeve;

3. Ruan dhe mbikëqyr asetet e IT-së duke u bazuar në politikat dhe procedurat e IT;

4. Menaxhon kapacitetin e rrjetit, “harduerit” duke u siguruar që është në përputhje me kërkesat e biznesit të ndërmarrjes;

5. Dizajnon, vlerëson dhe përkrahë infrastrukturën e IT dhe mbikëqyr ofrimin e shërbimeve të IT për të gjithë personelin e ndërmarrjes;

6. Kontribuon në zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë së IT;

7. Mblkëqyr zhvillimin dhe zbatimin e politikave, procedurave, standardeve dhe udhëzuesve të IT;

8. Kujdeset për menaxhimin e qasjes së përdoruesve dhe kontrollin e qasjes;

